

iSIGURIMET

Nr. #018 • Gusht 2020 • www.shs-ks.com

f # InsuranceAssociationofKosova

Automjetet e paregjistruara do të
detektohen me pajisje digjitale në
hyrje-daljet e qyteteve

08



RAJONI I PRISHTINËS,
“KAMPION” I KOSOVËS
ME AKSIDENTE TRAFIKU

06

DEKADË E PËRGGJAKUR, 1317 TË VDEKUR NË AKSIDENTE KOMUNIKACIONI NË KOSOVË


Në Kosovë, gjatë dekadës së fundit në aksidente komunikacioni kanë humbur jetën 1317 persona. Numri më i madh i të vdekurve në komunikacion është regjistruar në vitin 2010, kur shifra kishte arritur në 175. 04

6.3 VDEKJE

PËR 100 MIJË BANORË ËSHTË
SHKALLA E VDEKJEVE NGA
AKSIDENTET RRUGORE
NË KOSOVË.


10 vite, 180 mijë aksidente trafiku në Kosovë

Në dekadën e fundit, përkatësisht gjatë viteve 2010-2019, në Republikën e Kosovës janë regjistruar rreth 180 mijë aksidente trafiku. Këto statistika bëhen të ditura në raportin e përbashkët të botuar së fundmi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit dhe Policia e Republikës së Kosovës me titull: Dekada e Sigurisë Rrugore 2010-2019. Sipas këtij raporti, numri më i madh i aksidenteve të përgjithshme gjatë dekadës së fundit është regjistruar në vitin 2013, kur kanë qenë gjithsej 19954 aksidente, ndërsa numri më i vogël i aksidenteve të komunikacionit është regjistruar në vitin 2018, kur kanë qenë 15741 sosh.



Për 10 vite, mbi 53 mijë qytetarë të lënduar në aksidente trafiku në Kosovë

Nga rreth 180 mijë aksidente trafiku të regjistruara përgjatë viteve 2010-2019 në Republikën e Kosovës, mbi 53 mijë kanë qenë më lëndime. Sipas një raporti të përbashkët të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit dhe Policisë së Republikës së Kosovës, numri më i vogël e aksidenteve me të lënduar është regjistruar në vitin 2010, kur kanë qenë 4326 aksidente me lëndime, ndërsa numri më i madh i aksidenteve me lëndime është regjistruar në vitin 2017, kur kanë qenë 6390 të tilla.



DEKADË E PËRGJAKUR, 175 AKSIDENTE KOMUNIKACIONI

Në Kosovë, gjatë dekadës së fundit në aksidente komunikacioni kanë humbur jetën 1317 persona. Numri më i madh i të vdekurve në komunikacion është regjistruar në vitin 2010, kur shifra kishte arritur në 175.

Viti	Personat e vdekur në aksidente komunikacioni
2010	175
2011	157
2012	121
2013	119
2014	127
2015	129
2016	110
2017	137
2018	129
2019	113

Në fillim të dekadës së kaluar, në Kosovë, në çdo të dytën ditë kishte vdekur një person në aksidente trafiku, apo 175 të vdekur në aksidente komunikacioni më 2010. Kjo bëhet e ditur në raportin e përbashkët të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit dhe Policisë së Kosovës, sipas të cilit numri i përgjithshëm i personave të vdekur në aksidente trafiku në Kosovë, përgjatë viteve 2010-2019, ka arritur në 1317. Sipas këtij raporti më së paku viktima në komunikacion ishin shënuar në vitin 2016, kur 110 persona kishin vdekur, ndërsa më së shumti kishte në vitin 2010, duke arritur në 175 viktima në komunikacion.

317 TË VDEKUR NË ONI NË KOSOVË

6.3 VDEKJE

për 100 mijë banorë është shkalla e vdekjeve nga aksidentet rrugore në Kosovë.

8.3 VDEKJE


për 100 mijë banorë është shkalla e vdekjeve nga aksidentet rrugore në vendet me të ardhura të ulëta.

1.35 MILIONË NJERËZ VDESIN ÇDO VIT NË AKSIDENTE TRAFIKU NË NIVEL GLOBAL

Rreth 1.35 milionë njerëz vdesin mesatarisht çdo vit në aksidente trafiku. Numri i vdekjeve në botë në aksidente trafiku vazhdon të rritet nga viti në vit, ku në vitin 2016 kishin vdekur 1.35 milion njerëz. Sipas raportit të lartpërmendur, shkalla e vdekjes në krahasim me madhësinë e popullsisë në botë ka mbetur konstante. Disa vende të botës kanë pasur sukses në zvogëlimin e vdekjeve në trafikun rrugor gjatë viteve të fundit, por progresi ndryshon dukshëm midis rajoneve dhe vendeve të ndryshme të botës. Rreziku i vdekjes në trafikun rrugor është më shumë se tri herë më i lartë në vendet me të ardhura më të ulëta se sa në vendet me të ardhura më të larta, ku shkalla mesatare është 8.3 vdekje për 100 mijë banorë. Në anën tjetër, shkalla e vdekjeve nga aksidentet rrugore në 100 mijë banorë në Kosovë është 6.3 vdekje.

406 këmbësorë vdiqën në aksidente trafiku për një dekadë

Gjatë dekadës në fundit në aksidente të ndryshme trafiku në Kosovë kanë humbur jetën 406 këmbësorë. Në vitin 2010 kishin vdekur më shumë këmbësorë në aksidente trafiku, përkatësisht 60 të vdekur, ndërsa më së paku këmbësorë kanë vdekur në vitin 2016, apo 25 të vdekur. Sipas statistikave të institucioneve përkatëse në Kosovë, Ministrisë së Transportit dhe Policisë së Kosovës, në vitin 2010 kishin vdekur 17 këmbësor të grupmoshave 0-12 vjeç. Ndërsa në vitin 2017 kishin vdekur 11 këmbësorë të grupmoshave 13-18 vjeç.



Këmbësorë të vdekur

RAJONI I PRISHTINËS, “KAMPION” I KOSOVËS ME AKSIDENTE TRAFIKU


Nga të gjitha rajonet e Kosovës, Prishtina prinë për nga numri i aksidenteve në komunikacion. Kjo gjë bëhet e ditur në raportin: Dekada e sigurisë 2010-2019 të përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Policia e Kosovës. Pas Prishtinës për numrin më të madh të aksidenteve radhitet rajoni i Prizrenit, ai i Pejës, etj.

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
AUTOSTRADË	0	0	0	71	233	365	402	457	478	565
PRISHTINË	8056	8342	8691	9596	7437	8157	8160	7604	6493	6824
GJILAN	1588	1576	1589	1536	1281	1380	1413	1384	1256	1237
FERIZAJ	1463	1545	1699	1551	1373	1565	1750	1769	1419	1355
PRIZREN	2600	3183	3221	2854	2263	1662	2062	1941	1974	1924
GJAKOVË	0	0	0	0	0	1194	1083	1062	974	1098
PEJË	2850	2750	2957	2574	2220	1793	1940	1847	1693	1774
MITROVICË –JUG	1474	1492	1597	1680	1315	1440	1562	1476	1313	1283
MITROVICË-VERI	0	0	0	0	179	166	169	155	161	139

Aksidentet fatale sipas rajoneve, prinë Prishtina dhe Peja

Mbi 340 aksidente fatale janë regjistruar në rajonin e Prishtinës përgjatë viteve 2010-2019, përderisa numri më i madh i kwtire aksidente ishte shënuar në vitin 2010, kur ishin regjistruar 48 aksidente të tilla. Në rajonin e Gjilanin në dekadën e fundit janë regjistruar 116 aksidente fatale, ndërsa numri më i madh i aksidenteve të tilla ishte regjistruar në vitin 2012 me 19 sosh. Rajoni i Ferizajt ka regjistruar 5 aksidente fatale më pak se rajoni i Gjilanit në dekadën e fundit. Në rajonin e Prizrenit gjatë viteve 2010-2019 janë regjistruar 146 aksidente fatale, përderisa në rajonin e Gjakovës 52 të tilla. Në rajonin e Pejës gjatë dekadës së fundit janë shënuar 200 aksidente fatale. Në rajonin e Mitrovicës së Jugut janë shënuar 99 aksidente fatale, ndërsa në Mitrovicën e Veriut janë regjistruar 22 aksidente fatale. Në Autostradë janë regjistruar 44 aksidente fatale në 7 vitet e fundit.

AKSIDENTET FATALE GJATË DEKADËS SË FUNDIT



Automjetet e paregjistruara do të detektohen me pajisje digjitale në hyrje-daljet e qyteteve

Ministri i Infrastrukturës Arban Abrashi, ka pritur në takim drejtorin ekzekutiv të Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Sami Mazrekun, me të cilin ka diskutuar lidhur me mundësitë e bashkëpunimit ndërinstitucional. Siç thuhet në komunikatën për media, Mazreku e ka njoftuar ministrin Abrashi lidhur me disa çështje që bien në fushëveprimin e rregullimit të Ministrisë së Infrastrukturës, ndër të cilat: Domosdoshmërinë e plotësim-ndryshimit të Ligjit për Automjetet; Nevojën për rishikimin e Strategjisë Rrugore dhe Planin e Veprimit; Digjitalizimi i sigurisë së rrugëve, dhe; Zhvillimin e fushatave të përbashkëta për rritjen e vetëdijesimit të qytetarëve për sigurinë në trafik.

Ndryshimet legislative përkatëse përfshijnë vlerësimin e heqjes së pengesave dhe kushtëzimeve të ndryshme për qytetarët në regjistrimin e mjeteve motorike, siç janë ato të pagesës së gjobave dhe taksave komunale, bartjen e periudhës së regjis-



trimit në pronarin e ri në rastin e shitblerjes së mjetit motorik dhe çështje të tjera të ngjashme.

Rishikimi i Strategjisë Rrugore dhe Planit të Veprimit ka për qëllim përfshirjen më të gjerë të palëve të interesit në dhënien e kontributit të tyre në marrjen e masave efektive për të krijuar

siguri më të lartë për qytetarët. Në këtë proces do të kenë mundësinë e përfaqësimit edhe përfaqësuesit sektorialë, organizatat përfaqësuese të kontrolleve teknike, autoshollave dhe të tjerë. Sa i përket digjitalizimit, duke i pasur parasysh vitet e fundit, sipas statistikave zyrtare, numri i mjeteve motorike të pasiguruara e të paregjistruara është rritur dukshëm, do të vendosen pajisjet digjitale të cilat do të detektojnë këto mjete nëpër të gjitha hyrje-daljet e qyteteve të Republikës së Kosovës dhe brenda tyre. Ndërkaq, fushatat do të fokusohen në rritjen e vetëdijesimit të qytetarëve në respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre gjatë pjesëmarrjes në trafik. Për realizimin e këtij bashkëpunimi, palët janë zotuar që në ditët në vijim të nënshkruajnë një memorandum bashkëpunimi ku do të trajtohen temat si më sipër dhe përgjegjësitë institucionale në këtë drejtim.

Drejtori Mazreku ka takuar Udhëheqësin e Divizionit Civil të Gjykatës Themelore në Prishtinë

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Sami Mazreku, ka takuar udhëheqësin e Divizionit Civil të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, Adnan Konushevc, si dhe Hasie Abdullahu – Hajdini, ADR Specialist në Checchi and Company Con-

sulting, kontraktuar nga USAID.

Në këtë takim është diskutuar për rëndësinë e trajtimit të kërkesave dhe padive të palëve të dëmtuara me lëndime të lehta në aksidente të komunikacionit përmes procedurës së Ndërmjetësimit, me qëllim të zgjidhjes së çështjeve kontestuese në mënyrë sa më praktike, kompensimit më të shpejtë të palëve dhe uljen e kostos së shpenzimeve të procedurës gjyqësore.

Palët kanë mundësi që me pajtimin e përbashkët, të fillojnë procedurën e ndërmjetësimit për zgjidhjen e kontesteve për kompensimin e dëmeve ku janë shkaktuar lëndimet e lehta, për çka do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë uljen e numrit të lëndëve në gjykatë dhe zgjidhjen e shpejtë të kërkesave.



Automjetet e paregjistruara do të trajtohen institucionalisht

Shoqata e Sigurimeve të Kosovës mirëpret iniciativën e Qeverisë së Kosovës dhe Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), për trajtimin e automjeteve të paregjistruara në vendin tonë. Shoqata e Sigurimeve, e përkrahur edhe nga guvernatori BQK-së Fehmi Mehmeti, në vazhdimësi e ka ngritur problemin e automjeteve të paregjistruara, të cilat u sjellin dëme të mëdha si kompanive të sigurimit, ashtu edhe institucioneve të Kosovës.



Shoqata e Sigurimeve ka marrë pjesë në seminarin-prezantimin e organizuar nga The Institutes -USA, organizatë e cila merret me trajnime dhe edukim, ku morrën pjesë vendet e Evropës Jug-Lindore.

